



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 75

2003

Shtator

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.9118 datë 24.7.2003	Për faljen e kamatëvonesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore të paguara..... 3427
Ligj nr.9120 datë 28.7.2003	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë"..... 3428
Vendim i KM nr.575, datë 21.8.2003	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.796, datë 24.12.1998 të Këshillit të Ministrave "Për të ardhurat e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë (QKK), për shpërblimet e këshillave miratuese të projekteve të komisionit të vizionimit dhe komisionit financiar"..... 3430
Vendim i KM nr.576, datë 21.8.2003	Për miratimin e ndryshimeve në Marrëveshjen e kredisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor (IFAD) për programin e zhvillimit të zonave malore..... 3431
Vendim i KM nr.581, datë 21.8.2003	Për një ndryshim në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore" i ndryshuar..... 3434

Vendim i KM nr.582, datë 21.8.2003	Për miratimin e metodologjisë së rregullimit të tarifave të organizmave me fuqi të ndjeshme në treg, që ofrojnë shërbime publike telefonike të qëndrueshme dhe linja me qira.....	3434
Udhëzim i KQZ nr.3, datë 9.8.2003	Për organizimin dhe funksionimin e KZQV-së.....	3438
Vendim i KKRT nr.149, datë 30.7.2003	Për heqjen e licencës së ALBA TV.....	3448
Vendim i KKRT nr.150, datë 30.7.2003	Për dhënie licence për ritransmetim të programeve të huaja televizive në Shqipëri "RAI 1".....	3451
Vendim KKRT nr.153, datë 30.7.2003	Për dhënie licence për televizionin vendor privat "TV Apollon"	3451
Vendim i KKRT nr.154, datë 30.7.2003	Për dhënie licence për televizionin vendor privat "2A TV".....	3452
Vendim i KKRT nr.155, datë 30.7.2003	Për dhënie licence për televizionin vendor privat "TV Malësia"	3452
Vendim i KKRT nr.156, datë 30.7.2003	Për dhënie licence për televizionin vendor privat "TV Jehona e Malësisë".....	3453
Vendim i KKRT nr.157, datë 30.7.2003	Për dhënie licence për televizionin vendor privat "TV Bushati".	3453
Vendim i KKRT nr.158, datë 30.7.2003	Për dhënie licence për radio vendore private "Magic".....	3454

L I G J
Nr.9118, datë 24.7.2003

PËR FALJEN E KAMATËVONESAVE TË KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE
SHOQËRORE TË PAPAGUARA

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Falen kamatëvonesat e kontributeve për sigurimet shoqërore të paguara deri në datën 31.12.2002 nga ndërmarrjet dhe shoqëritë me kapital tërësisht shtetëror, nga ndërmarrjet dhe shoqëritë me kapital të përbashkët me shtetin, nga personat juridikë e fizikë privatë dhe nga personat e vetëpunësuar në bujqësi, me kusht që detyrimet për kontributet të arkëtohen brenda datës 31 dhjetor 2004.

Neni 2

Pushohet ekzekutimi i vendimeve të gjykatave, që kanë marrë formë të prerë deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, për pjesën e kamatëvonesave të sigurimeve shoqërore të paguara, të cilat falen me këtë ligj.

Neni 3

Kamatëvonesat e kontributeve për sigurimet shoqërore, të paguara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk rikthehen.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.3944, datë 19.8.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

L I G J
Nr.9120, datë 28.7.2003

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8461, DATË 25.2.1999 "PËR
ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 8 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

"Titullari i shkollave të larta ushtarake emërohet nga Ministri i Mbrojtjes nga radhët e oficerëve madhorë dhe me gradë shkencore, ndërsa titullari i Akademisë së Policisë emërohet sipas ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit".".

2. Pas paragrafit të dytë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Shkolla e lartë ushtarake është institucion arsimor, në varësi të strukturave hierarkike të Ministrisë së Mbrojtjes, ndërsa Akademia e Policisë është institucion arsimor, në varësi të strukturave hierarkike të Ministrisë së Rendit Publik.".

Neni 2

Pas paragrafit të dytë të nenit 15 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Këshilli drejtues është organi më i lartë kolegjal i shkollës së lartë ushtarake.".

Neni 3

Paragrafi i tretë, i katërt dhe i pestë të nenit 17 zëvendësohen me paragrafët me këtë përmbajtje:

"Këshilli i fakultetit ose i shkollës së lartë jouniversitare përbëhet nga përfaqësuesit e zgjedhur nga departamentet, nga personeli joakademik dhe nga studentët. Këshilli i fakultetit ose i shkollës së lartë jouniversitare (në rastin kur shkolla jouniversitare është strukturë e universitetit) zgjedh, me shumicë votash, përfaqësuesit e vet në senatin e shkollës së lartë universitare.

Senati i shkollës së lartë universitare përbëhet nga përfaqësuesit e zgjedhur nga këshillat e fakulteteve e të shkollave të larta jouniversitare dhe nga studentët.

Dekani i fakultetit zgjidhet nga personeli akademik i brendshëm, nga përfaqësuesit e zgjedhur nga personeli joakademik dhe përfaqësuesit e zgjedhur nga studentët e këtij fakulteti.

Rektori i shkollës së lartë universitare ose drejtori i shkollës së lartë jouniversitare zgjidhet nga personeli akademik i brendshëm, nga përfaqësuesit e zgjedhur nga personeli joakademik dhe përfaqësuesit e zgjedhur nga studentët. Përfaqësuesit e zgjedhur nga personeli joakademik dhe përfaqësuesit e zgjedhur nga studentët, që votojnë për zgjedhjen e rektorit, janë po ata që votojnë për zgjedhjen e dekanit.

Zgjedhjet bëhen me votim të fshehtë. Procedurat dhe kriteret për pjesëmarrje në zgjedhjet e të gjitha kategorive të punonjësve të shkollave të larta dhe të studentëve përcaktohen në rregulloren për zgjedhjet në shkollat e larta, që miratohet nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës. Kjo rregullore, dita e fillimit të zgjedhjeve dhe afatet e realizimit të tyre, në të gjitha shkollat e larta, shpallen nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës.".

Neni 4

Në nenin 19 të ligjit ekzistues, fjalia: "Autoritetet drejtuese të shkollave të larta publike zgjidhen çdo tre vjet", zëvendësohet me fjalinë: "Autoritetet drejtuese të shkollave të larta publike zgjidhen çdo katër vjet".

Neni 5

Në nenin 20 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në fjalinë e parë, togfjalëshi "titujt më të lartë" zëvendësohet me "gradë dhe tituj".
2. Në fjalinë e dytë, togfjalëshi "përcaktohen titujt" zëvendësohet me "përcaktohen grada dhe titujt".

Neni 6

Paragrafi i fundit i nenit 24 ndryshohet si më poshtë:

"Arsimimi i ushtarakëve dhe i punonjësve të Policisë së Shtetit në shkollat e larta civile, në sistemin e shkollimit, me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, është pjesë e arsimimit të tyre të plotë, që kryhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 31 të këtij ligji. Shpenzimet për këtë arsimim përballohen nga Ministria e Mbrojtjes për ushtarakët dhe nga Ministria e Rendit Publik për punonjësit e Policisë së Shtetit."

Neni 7

Në nenin 31 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

"Pranimet në shkollat e larta publike bëhen me kuota të parashikuara. Kuotat për sistemin e studimeve me kohë të plotë ndahen në kuota kryesore dhe kuota dytësore. Kuotat kryesore të pranimit për sistemin e studimeve me kohë të plotë propozohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave. Për sistemin e studimeve me kohë të pjesshme kuotat përcaktohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Në përcaktimin e kuotave kryesore dhe kuotave për sistemin e studimeve me kohë të pjesshme, Ministria e Arsimit dhe Shkencës merr mendimin e shkollave të larta. Kuotat dytësore dhe kuotat e sistemit të studimit me kohë të pjesshme janë kuota, për të cilat zbatohen tarifa të veçanta shkollimi.

2. Në fjalinë e fundit të paragrafit të tretë, pas togfjalëshit "kuotat dytësore", shtohet "dhe sistemin e studimeve me kohë të pjesshme".

3. Fjalia e parë e paragrafit të katërt ndryshohet si më poshtë:

"Pranimet në shkollën e lartë publike bëhen me konkurs. Kur numri i kandidatëve të regjistruar është më i vogël se kuota e parashikuar, pranimet bëhen pa konkurs."

Neni 8

Në fund të nenit 32 shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

"Studentët në çdo shkollë të lartë universitare zgjedhin qeverinë studentore.

Studentët pajisen me kartën e studentit."

Neni 9

Paragrafi i parë i nenit 35 zëvendësohet me paragrafët me këtë përmbajtje:

"Sistemi i studimeve në shkollën e lartë është me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme.

Kohëzgjatja e studimeve të plota në shkollat e larta universitare llogaritet në vite akademike dhe nuk është më pak se tre vjet."

Neni 10

Në nenin 38 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në paragrafin e parë, të dytë dhe të katërt togfjalëshi "Diploma/ën e studimeve të thelluara pasuniversitare" zëvendësohet me "Master".

2. Pas paragrafit të katërt shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Studimet për të marrë diplomën e shkollës pasuniversitare dhe për doktoraturë në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kryhen në Akademinë e Mbrojtjes, ndërsa në fushën e rendit dhe të sigurisë publike kryhen në Akademinë e Policisë."

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3929, datë 14.8.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

V E N D I M
Nr.575, datë 21.8.2003

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.796, DATË 24.12.1998 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR TË ARDHURAT E QENDRËS KOMBËTARE TË
KINEMATOGRAFISË (QKK), PËR SHPËRBLIMET E KËSHILLAVE MIRATUESE TË
PROJEKTEVE TË KOMISIONIT TË VIZIONIMIT DHE KOMISIONIT FINANCIAR"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 dhe 40 të ligjit nr.8096, datë 21.3.1996 "Për kinematografinë" dhe të nenit 8 të ligjit nr.8983, datë 20.12.2002 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003", me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.796, datë 24.12.1998 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 e shkronjës "B" ndryshohet si më poshtë vijon:

"1. Pagesat (shpërblimet) e këshillave miratuese të projekteve:

- 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për sesion, shpërblimet e anëtarëve të këshillit miratues të projekteve të filmit artistik.

- 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë për sesion, shpërblimet e anëtarëve të këshillit miratues të projekteve të filmit dokumentar.

- 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë për sesion, shpërblimet e anëtarëve të këshillit miratues të projekteve të filmit vizatimor."

2. Pika 2 e shkronjës "B" ndryshohet si më poshtë vijon:

"2. Shpërblimet e anëtarëve të komisionit financiar:

- 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë për sesion, shpërblimet e anëtarëve të komisionit financiar të filmit artistik.

- 8 000 (tetë mijë) lekë për sesion, shpërblimet e anëtarëve të komisionit financiar të filmit dokumentar.

- 8 000 (tetë mijë) lekë për sesion, shpërblimet e anëtarëve të komisionit financiar të filmit vizatimor."

3. Pika 3 e shkronjës "B" ndryshohet si më poshtë vijon:

"3. Shpërblimet e anëtarëve të komisionit të vizionimit:

- 2 000 (dy mijë) lekë për çdo vizionim filmi."

4. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

"3/1 Pagesat e shpërblimeve të ndryshojnë në përputhje me ndryshimin e indeksit të pagave në sektorin buxhetor."

5. Pas shkronjës "B" shtohet shkronja "C", me këtë përmbajtje:

"C. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Kinematografisë për zbatimin e këtij vendimi."
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.576, datë 21.8.2003

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË MARRËVESHJEN E KREDISË NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT NDËRKOMBËTAR PËR ZHVILLIMIN
BUJQËSOR (IFAD), PËR PROGRAMIN E ZHVILLIMIT TË ZONAVE MALORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 6 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Financave, të Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe të Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e ndryshimeve në Marrëveshjen e kredisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor (IFAD), për programin e zhvillimit të zonave malore, si më poshtë vijon:

- a) Rritja e kufirit të llogarisë speciale "A" nga 500 000 USD në 800 000 USD.
- b) Rritja e kategorisë "Shtesë për kredinë" nga 730 000 SDR në 1 230 000 SDR dhe zvogëlimi i kategorisë "Të papërcaktuara" nga 2 220 000 SDR në 1 720 000 SDR.
- c) Përfshirja në kategorinë "Punime civile": rehabilitimi i rrugëve rurale, i ujësjellësave lokale dhe për nënprojektet e tjera, që rrisin prodhimin bujqësor.
- ç) Përfshirja në kategorinë "Trajnime dhe studime": shpenzime për trajnime dhe studime, brenda dhe jashtë vendit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

IFAD
Fondi Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor
Zoti Ministër

Subjekti: Republika e Shqipërisë: IFAD huaja nr.526-AL (Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore)

Amendament për Marrëveshjen e Huasë

1. Referuar Marrëveshjes së huasë, datë 28 janar 2000, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (këtu e më poshtë do të quhet "Huamarrësi") dhe Fondit Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor (këtu e më poshtë do të referohemi si "Fondi") për realizimin e programit të zhvillimit të zonave malore.

Duke ju referuar letrës suaj, datë 8 maj 2003 që kërkonte amendamentin e Marrëveshjes së Huasë.

2. Kam kënaqësinë t'ju informoj që Fondi aprovon kërkesën tuaj dhe kështu, Marrëveshja e huasë është amenduar si më poshtë:

I. Neni 2, seksioni 2.03 (b) do të amendohet dhe do të lexohet si më poshtë:

"(b) Pasi llogaria speciale A të jetë hapur në mënyrën e duhur, me kërkesë të Huamarrësit, Fondi do të bëjë një tërheqje prej tetëqind mijë dollarësh (USD 800 000) ("Shpërndarje e autorizuar") nga llogaria e huasë në emër të Huamarrësit dhe të depozitojë një shumë të tillë në llogarinë speciale A. Fondi do të rimbushë herë pas here, llogarinë speciale A në bazë të kërkesës në përputhje me

seksionin 4.08 të kushteve të përgjithshme (Llogaria speciale), me një shumë të tillë minimale sa fondi ose institucioni kooperues në emër të Fondit, mund të specifikojë sipas njoftimit të Huamarrësit."

II. Skedula 1, paragrafi 5.c, do të amendohet dhe do të lexohet si më poshtë:

"(c) Komponenti i infrastrukturës rurale. MADA do të financojë rehabilitimin e deri në 6 400 ha skema të vogla ujëtare me rrjedhje të lirë. Rehabilitimi do të përfshijë përmirësime të veprave marrëse dhe ose/rezervuarëve, kanaleve kryesore dhe dytësore, riparimin dhe zëvendësimin e mbulesave dhe ndërtimin e strukturave për kontrollin e ujit.

SHKËLQESIA E TIJ
MINISTËR I FINANCAVE I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
BULEVARDI "DËSHMORËT E KOMBIT"
TIRANË, REPUBLIKA E SHQIPËRISË

CC. MINISTRIT TË BUIQËSISË DHE TË
USHQIMIT
SHESHI "SKËNDERBEJ", 3
TIRANË, REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Përveç kësaj, programi do të financojë rehabilitimin deri në 40 rrugë rurale dhe nënprojekte për ujësjellësa fshati në përgjigje të kërkesës nga komunitetet përkatëse. Rrugët rurale do të financohen aty ku mungesa e tyre përbën një pengesë serioze për prodhimin bujqësor dhe zhvillimin ekonomik të zonës. Në mënyrë të ngjashme, ujësjellësat do të ndërtohen aty ku nuk gjendet asnjë agjenci alternative financuese dhe ku përfitimi social është tepër i dukshëm."

III. Skedual 2, tabela e alokimit, do të amendohet dhe do të lexohet si më poshtë:

Lidhja 1

KATEGORIA	SHUMA E HUASË SË ALOKUAR (SHPREHUR NË EKUIVALENT NË SDR)	SHUMA E GRANTIT TË ALOKUAR (SHPREHUR NË EKUIVALENT NË SDR)	% E SHPENZIMEVE TË LIGJSHME PËR TË FINANCUAR
PUNIME CIVILE	2 120 000		100% NET TAKSA
AUTOMJETE, PAJISJE DHE MATERIALE	1 040 000		100% NET TAKSA
SHËRBIME BUIQËSORE	1 120 000		100%
KREDI E MBARTUR	1 230 000		100% E NËNHUASË E DISBURSUAR NGA MAFF
TRAJNIME DHE STUDIME	460 000	-	100% E SHPENZIMEVE
ASISTENCË TEKNIKE			
A) PËR MAFF	-	110 000	100%
B) PËR MADA	-	210 000	100%
KOSTO OPERATIVE E MBARTUR	1 910 000		80%
TË PAALOKUARA	1 720 000		
SHUMA	9 600 000	320 000	

IV. Aneksi 2, paragrafi 2 (a) do të amendohet dhe do të lexohet si më poshtë:

"(a) Punime civile" do të thotë çdo shpenzim tjetër ligjërish i pranueshëm për rehabilitimin e ujitjes, rrugë rurale, ujësjellësa lokale dhe nënprojekte të tjera, të cilët mund të rrisin prodhimin bujqësor".

V. Aneksi 3, paragrafi 2.1 do të amendohet dhe do të lexohet si më poshtë:

"2.1 Aktivitetet e rehabilitimit të ujitjes dhe të infrastrukturës rurale në komponentin e infrastrukturës rurale do të kryhet nga kontraktorë kompetentë në bazë të marrëveshjes me MADA.

Për aktivitetet e rehabilitimit të ujitjes, do të zbatohet metodologjia e mëposhtme:

Fermerët përfitues do të ndihmohen në formimin e shoqatave të përdoruesve të ujit (SHPU) ose grupeve të përdoruesve tradicionalë, të cilët do të marrin përsipër menaxhimin e skemave përpara ekzekutimit të ndonjë pune që është në kuadrin e programit. Ata do marrin pjesë aktive në projektimin dhe rehabilitimin e skemave të tyre ujitëse dhe aty ku është e përshtatshme, federatat e SHPU-ve (F/SHPU) do të ngrihen. Kriteret e pranueshme për rehabilitimin e skemave do të përfshijnë furnizimin e skemave me rrjedhje të lirë dhe mundësinë që gratë të përfaqësohen në kryesinë e shoqatave të përdoruesve të ujit."

3. Me përjashtim të modifikimeve të shprehura më sipër, Marrëveshja e huasë mbetet e pandryshuar dhe në fuqi të plotë dhe efektive.

4. Nëse ky propozim është i pranueshëm nga ana juaj, unë kam nderin t'ju kërkoj të firmosni gjashtë kopjet e letrës dhe t'i ktheni tri kopje të saj në Fond, e cila do të konsistojë si një marrëveshje formale ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe IFAd-it, e cila do bëhet efektive menjëherë pas datës së firmosjes së letrës nga ana juaj.

Ju lutemi, z.Ministër, të pranoni konsideratat e mia më të larta.

11.7.2003

Presidenti

Lennart Boge

V E N D I M
Nr.581, datë 21.8.2003

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.726, DATË 21.12.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE" I
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 e 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", i ndryshuar me propozimin e Ministrit të Shtetit pranë Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, të bëhet ndryshimi si më poshtë vijon:

Në lidhjen I, "Renditja e funksioneve sipas klasifikimit", të bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

- Në klasifikimin B3 shtohet emërtesa "Drejtor i kompanisë teatrore, shtetërore, qendrore të Ansamblit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve Popullore".

2. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i vitit 2003, miratuar për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe të Sporteve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data e emërimit në detyrë të Drejtorit të kompanisë teatrore, shtetërore, qendrore të Ansamblit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve Popullore.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.582, datë 21.8.2003

PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË RREGULLIMIT TË TARIFAVE TË
ORGANIZMAVE ME FUQI TË NDJESHME NË TREG, QË OFROJNË SHËRBIME
PUBLIKE TELEFONIKE TË QËNDRUESHME DHE LINJA ME QIRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 58, 59, 60 e 62 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 "Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë" dhe të neneve 121 e 124 të ligjit

nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e metodologjisë së rregullimit të tarifave të organizmave me fuqi të ndjeshme në treg, që ofrojnë shërbime publike telefonike të qëndrueshme dhe linja me qira, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr.465, datë 19.7.2001 i Këshillit të Ministrave "Për metodologjinë e rregullimit të tarifave të operatorit publik të telekomunikacioneve të Albtelecom, sh.a.", shfuqizohet.

3. Ngarkohet Enti Rregullator i Telekomunikacioneve për zbatimin e këtij vendimi dhe nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

METODOLOGJIA

E RREGULLIMIT TË TARIFAVE TË OPERATORËVE PUBLIKË TË TELEKOMUNIKACIONEVE QË OFROJNË SHËRBIME PUBLIKE TELEFONIKE TË QËNDRUESHME DHE LINJA ME QIRA

1. Tarifat e shërbimeve telefonike të qëndrueshme dhe të shërbimit të linjave me qira (lidhja nr.1), të ofruara nga operatorët publikë të telekomunikacioneve, për të cilat operatori është cilësuar nga ERT si organizëm me fuqi të ndjeshme në treg, do të bazohen në koston përkatëse të secilit zë shërbimi, duke siguruar një fitim bruto (përfshirë tatimin mbi fitimin) jo më të madh se 40% sipas formulës:

$$K \leq T \leq 1,4 K$$

Ku:

T - tarifa mesatare për ofrimin e secilit zë shërbimi

K - kosto mesatare e llogaritur nga operatori për secilin zë shërbimi

2. Ndryshimi i tarifave bëhet një herë në vit, në periudhën gusht-shtator. Tarifat e reja të llogaritura sipas pikës 1 të këtij vendimi propozohen nga operatori pas pranimit të bilancit financiar vjetor nga dega e tatim-taksave, të shoqëruara me të dhënat dhe analizën e detajuar për llogaritjen e koston mesatare dhe tarifës mesatare. Për vitin e parë të zbatimit të këtij vendimi, aplikimi i tarifave të reja të verifikuara nga ERT mund të bëhet në dy faza. Faza e parë do të shërbejë për të amortizuar reagimin e tregut dhe reduktimin deri në nivelin e pranuar nga tregu të subvencioneve midis shërbimeve. Faza e dytë do të fillojë jo më parë se 3 muaj nga fillimi i zbatimit të ndryshimeve tarifore.

3. Mënyra e llogaritjes së koston për secilin zë shërbimi përcaktohet nga ERT në bashkëpunim me operatorin dhe i njoftohet operatorit paraprakisht.

4. Tarifa mesatare për secilin zë shërbimi llogaritet si më poshtë:

a) Për zërat e shërbimeve "Instalime telefonike", "Mirëmbajtje mujore" dhe "Linja me qira": Shumatorja e prodhimit të numrit për secilin shërbim me tarifën përkatëse, pjesëtuar me shumatoren e numrit për secilin shërbim.

$$T_{mesatare} = \frac{\sum_{i=1}^n n_i \cdot t_i}{\sum_{i=1}^n n_i}$$

KU:

**NI - NUMRI I INSTALIMEVE TELEFONIKE TË KRYERA
BRENDA PERIUDHËS, NUMRI MESATAR I
PËRDORUESVE OSE NUMRI I LINJAVE ME QIRA.**

TI - TARIFA PËRKATËSE

b) Për zërat e shërbimeve "Komunikime telefonike automatike lokale

/kombëtare/ndërkombëtare": Shumatorja e prodhimit të trafikut të realizuar për secilin shërbim me tarifën përkatëse, pjesëtuar me shumatoren e trafikut për secilin shërbim.

$$T_{mesatare} = \frac{\sum_{i=1}^n TR_i \cdot ti}{\sum_{i=1}^n TR_i}$$

KU:
TRI - TRAFIKU I REALIZUAR PËR SECILIN SHËRBIM
TI - TARIFA PËRKATËSE

5. Tarifat e shërbimeve të jenë të njëjta për kategoritë e përdoruesve "Familjarë" dhe "Të tjerë".

6. Për shërbimet "Instalim telefonik" dhe "Mirëmbajtje mujore", duke respektuar relacionin e pikës 1 të këtij vendimi, operatori mund të zbatojë tarifa të ndryshme për zona të ndryshme brenda vendit.

7. Tarifat e shërbimeve të grupit "Komunikime telefonike automatike" të zbatohen në "lekë për kohë komunikim" ose nëpërmjet kombinimit të "numrit të impulseve të tarifimit" me "çmimin e impulsit". Diferenca më e madhe ndërmjet dy intervaleve të njëpasnjëshme të tarifimit për "Komunikimet telefonike automatike lokale" të jetë jo më shumë se 20 sekonda.

8. Në zërat e shërbimeve të grupit "Komunikime telefonike automatike" të mos zbatohen shkallëzime në rritje të tarifave për rritje të trafikut mujor të realizuar nga përdoruesit. Në këto zëra shërbimesh operatori mund të zbatojë tarifa fillestare me fillimin e komunikimit (start-up fee).

9. Për shërbimet e grupit "Komunikime telefonike automatike", operatori mund të zbatojë:

a) tarifa të veçanta për jo më shumë se tre nivele të ndryshme tarife (reduktuar, normal, pik) të shpërndarë në breza orare brenda ditës;

b) tarifa të veçanta për ditë të ndryshme të vitit, të tilla si ditë pune, e shtunë, e dielë, ditë festash zyrtare ose ditë promovionale;

c) tarifa të veçanta për grupe të ndryshëm përdoruesish për komunikimet brenda grupit.

10. Për zërin e shërbimit "Komunikime telefonike automatike kombëtare" operatori mund të zbatojë:

a) ndarje në zona të ndryshme tarife;

b) tarifa të ndryshme për të njëjtin drejtim komunikimi, por me kahe të kundërt, me kusht që tarifa mesatare e drejtimit të plotësojë kushtet e pikës 1.

11. Për zërin e shërbimit "Komunikime telefonike automatike ndërkombëtare", operatori mund të aplikojë ndarje në zona të ndryshme tarife për komunikimet drejt rrjeteve të operatorëve fiks dhe mobile.

12. Operatori i cilësuar organizëm me fuqi të ndjeshme në treg, nuk duhet t'iu ofrojë operatorëve të tjerë me të cilët është interkonektuar, tarifa më të larta se tarifatat përkatëse që iu ofron përdoruesve të tij.

GRUPET E SHËRBIMIT	ZËRAT E SHËRBIMIT	SHËRBIMET	EMËRTIMI	NJËSIA	TARIFA E SHËRBIMIT	TMESATARE
1	2	3	4	5	6	7
A			INSTALIME TELEFONIKE	LEKË		
	1		TARIFË INSTALIMI PËR LINJË TELEFONIKE PËRDORUESI	LEKË		T(1) MES
	2		TARIFË INSTALIMI PËR LINJË ME QIRA KOMBËTARE:	LEKË		T(2) MES
		2.1	ANALOGE	LEKË	T1	
		2.2	DIXHITALE 64 KBIT/S	64	T2	
		2.N	 DIXHITALE N X 64 KBIT/S (PËR SECILËN VLERË TË N NGA 2-30)	LEKË	TN	
	3		TARIFË INSTALIMI PËR LINJË ME QIRA NDËRKOMBËTARE	LEKË LEKË		T(3) MES
		3.1	ANALOGE	LEKË	T1	
		3.2	DIXHITALE 64 KBIT/SEK	64 LEKË	T2	
		3.N	 DIXHITALE B X 64 KBIT/S (PËR SECILËN VLERË TË N NGA 2-30)	LEKË	TN	
B			MIRËMBAJTJE MUJORE	LEKË/MUAJ		
	4		TARIFË MIRËMBAJTJE MUJORE PËR LINJË TELEFONIKE PËRDORUESI	LEKË/MUAJ		T(4) MES
	5		TARIFË MIRËMBAJTJE MUJORE PËR LINJË ME QIRA KOMBËTARE:	LEKË/MUAJ		T(5) MES
		5.1	ANALOGE	LEKË/MUAJ	T1	
		5.2	DIXHITALE 64 KBIT/S (TË NDARA SIPAS DISTANCAVE - OPSION QË E ZGJEDH OPERATORI):	64		

	5.2.1. - PËR DISTANCË DERI X KM	LEKË/MUAJ	T2	
	5.2. - PËR DISTANCË X- Y KM	LEKË/MUAJ	T3	
	5.2.3. - PËR DISTANCË Y - Z KM	LEKË/MUAJ	T4	
				
	5.2.M - PËR DISTANCË MBI M KM	LEKË/MUAJ	TM	
5.3	DIXHITALE N X 64 KBIT/S (TË NDARA SIPAS DISTANCAVE PËR ÇDO VLERË TË ZBATUAR TË "N"- OPSION QË E ZGJEDH OPERATORI):			
	5.3.1 - PËR DISTANCË DERI X KM	LEKË/MUAJ	T5	
	5.3.2 - PËR DISTANCË X - Y KM	LEKË/MUAJ	T6	
	5.3.3 - PËR DISTANCË Y - Z KM	LEKË/MUAJ	T7	
				
	5.3 M. - PËR DISTANCË MBI M KM	LEKË/MUAJ	TM	
6	TARIFË MIRËMBAJTJE MUJORE PËR LINJË ME QIRA NDËRKOMBËTARE: (SIPAS ZONAVE DHE SHPEJTËSISË - OPSION QË E ZGJEDH OPERATORI):	LEKË/MUAJ		T(6) MES
	6.1 ZONA "I"			
	6.1.1 - ME SHPEJTËSI 64 KBIT/S	LEKË/MUAJ	T1	
	6.1.N - ME SHPEJTËSI N X 64 KBIT/S	LEKË/MUAJ	TN	
	6.N. ZONA "N"			
	6.1.1 - ME SHPEJTËSI 64 KBIT/S	LEKË/MUAJ	T1	
	6.1.N - ME SHPEJTËSI N X 64 KBIT/S	LEKË/MUAJ	TN	
C	KOMUNIKIME TELEFONIKE AUTOMATIKE			
7	TARIFA E KOMUNIKIMEVE AUTOMATIKE	LEKË/MIN	T1	T(7) MES

8	LOKALE TARIFA KOMUNIKIMEVE TELEFONIKE AUTOMATIKE KOMBËTARE	E	LEKË/MIN	T(8) MES
8.1	BRENDË RRETHIT		LEKË/MIN	T2
8.2	NDËRMJET RRETHEVE (OPERATORI MUND TË PËRDORË OSE JO NDARJE NË ZONA)			
	8.2.1 - ZONA 1 (PËR DISTANCË DERI X KM)		LEKË/MIN	T3
	8.2.2 - ZONA 2 (PËR DISTANCË X - Y KM)		LEKË/MIN	T4
	...			
	8.2. N - ZONA N (PËR DISTANCË MBI M KM)		LEKË/MIN	TM
8.3	DREJT OPERATORËVE PUBLIK MOBILE (VENDAS)		LEKË/MIN	T5
8.4	DREJT OPERATOREVE PUBLIK FIKS (VENDAS) (SIPAS ZONAVE KU OPERON SECILI PREJ OPERATORËVE)		LEKË/MIN	T6
9	TARIFA KOMUNIKIMEVE TELEFONIKE AUTOMATIKE NDËRKOMBËTARE	E	LEKË/MIN	T(9) MES
9.1	DREJT RRJETEVE FIKS (OPERATORI MUND TË PËRDORË OSE JO NDARJE NË ZONA)			
	9.1.1 - ZONA 1		LEKË/MIN	T1
	9.1.2 - ZONA 2		LEKË/MIN	T2
				
	9.1..N - ZONA N		LEKË/MIN	TN
9.2	DREJT RRJETEVE MOBILE (OPERATORI MUND TË PËRDORI OSE JO NDARJE NË ZONA)			
	9.1.1 - ZONA 1		LEKË/MIN	T3
	9.1.2 - ZONA 2		LEKË/MIN	T4
				

Shënim: Emërtimet e shërbimeve të mësipërme janë orientuese dhe mund të ndryshohen në përputhje me zhvillimin e terminologjisë dhe teknologjisë së telekomunikacioneve.

U D H Ë Z I M
Nr.3, datë 9.8.2003

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KZQV-SË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 9.8.2003, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi Kryetar
Dodë Prenga Anëtar
Pandeli Varfi Anëtar
Maksim Shimani Anëtar
Tomor Malaj Anëtar
Klemen Zguri Anëtar

Në mbështetje të nenit 29/1 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”,

U D H Ë Z O N:

PJESA I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim del në bazë dhe për zbatim të ligjit nr.9087, datë 16.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” dhe ka për qëllim të rregullojë mënyrën e organizimit dhe funksionimit të KZQV-së, të drejtat dhe detyrimet e saj dhe të anëtarëve, caktimin e rregullave për thirrjen dhe zhvillimin e mbledhjeve, marrjen e vendimeve, caktimin e rregullave mbi marrëdhëniet e KZQV-së me të tretët.

Neni 2
Parime të përgjithshme

KZQV-ja është përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, në bashkinë ose komunën përkatëse. Të drejtat dhe detyrat e saj përcaktohen në Kodin Zgjedhor dhe në këtë udhëzim.

Komisioni Zgjedhor për Qeverisjen Vendore organizohet, funksionon dhe merr vendime në përputhje me Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë dhe aktet normative të nxjerra nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

PJESA II
EMËRIMI I ANËTARËVE TË KZQV-SË DHE SHKARKIMI I TYRE

Neni 3
Përbërja dhe ringritja e KZQV-së

1. KZQV-ja është organ kolegjal. Ajo përbëhet nga shtatë anëtarë, të cilët emërohen sipas

procedurës së parashikuar nga neni 40/1.a.b i Kodit Zgjedhor.

2. KZQV-ja duhet të ringrihet jo më vonë se 1 muaj nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve vendore nga KQZ-ja, sipas procedurës së parashikuar në nenin 40/1.a.b të Kodit Zgjedhor.

3. KQZ-ja jo më vonë se 15 ditë nga shpallja e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve vendore, me vendim përcakton partitë, të cilat kanë të drejtë të paraqesin propozimet për anëtarë të KZQV-së për çdo rast.

4. Në zbatim të nenit 40/1.a dhe të nenit 40/10 të Kodit Zgjedhor do të kuptohet:

a) Parti kryesore qeverisëse, partia e cila ka numrin më të madh të deputetëve në Kuvend dhe është pjesëmarrëse në qeveri në momentin, kur shpallet rezultati përfundimtar i zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

b) Parti kryesore e opozitës parlamentare, partia e cila ka numrin më të madh të deputetëve në Kuvend dhe nuk është pjesëmarrëse në qeveri në momentin, kur shpallet rezultati përfundimtar i zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

c) Parti e dytë për nga numri i votave në zgjedhjet e fundit për organet e qeverisjes vendore, brenda spektrit politik qeverisës është partia, e cila është e dyta në numrin e votave, të marra në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore së bashku, në votimin për këshillat e bashkisë dhe/ose komunës dhe që është pjesëmarrëse në qeveri në momentin, kur shpallet rezultati përfundimtar i zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

d) Partia e dytë për nga numri i votave në zgjedhjet e fundit për qeverisjen vendore brenda spektrit politik të opozitës është partia e cila është e dyta në numrin e votave, të marra në të gjithë njësitë e qeverisjes vendore së bashku, në votimin për këshillat e bashkisë dhe/ose komunës dhe që nuk është pjesëmarrëse në qeveri në momentin kur shpallet rezultati përfundimtar i zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

5. KQZ-ja iu dërgon njoftim partive politike, që kanë të drejtë të paraqesin propozime për anëtarë të KZQV-së për të sjellë kandidaturat të shoqëruara me dokumentacionin përkatës.

6. Kur KQZ-ja konstaton se kandidatura e propozuar plotëson kërkesat e nenit 40/3, 4, 5 të Kodit Zgjedhor merr vendim për emërimin e tij.

Vendimi i dërgohet menjëherë partisë politike që ka bërë propozimin. Një kopje e vendimit shpallet publikisht dhe në hyrje të bashkisë/komunës përkatëse.

Neni 4

Kriteret për emërimin e anëtarëve

Anëtarët e KZQV-së, krahas kritereve të përcaktuara në nenin 40 pikat 3, 4 dhe 5 të Kodit Zgjedhor duhet të plotësojnë në periudhën 28 ditë përpara datës së zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit nga KZQV-ja edhe këto kushte:

a) të mos ketë lidhje familjare (nënë, baba, fëmijë, motër, vëlla, bashkëshort) me ndonjë prej kandidatëve, në njësinë vendore ku është anëtar;

b) të mos ketë lidhje biznesi me ndonjë prej kandidatëve, në njësinë vendore ku është anëtar.

Shkarkimi i anëtarëve të KZQV-së

Neni 5

Anëtari i KZQV-së mundet të shkarkohet për një nga rastet e mëposhtme:

a) për shkelje të Kushtetutës;

b) për paafësi mendore ose fizike që pengojnë në kryerjen e detyrës;

c) për sjellje dhe akte që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e anëtarit të KZQV-së;

ç) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;

d) kur mungon pa shkaqe të arsyeshme në dy mbledhje radhazi të KZQV-së;

dh) kur nuk paraqitet në detyrë, pa shkaqe të arsyeshme, për më shumë se 2 ditë në periudhë zgjedhore;

e) kur nuk plotëson kërkesat e nenit 20 të Kodit Zgjedhor lidhur me shtetësinë dhe të nenit 40 pikat 3, 4, 5 të Kodit Zgjedhor dhe neni 4 të këtij udhëzimi në lidhje me kushtet për të qenë anëtar i KZQV-së;

f) nuk përmbush detyrat e parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe aktet nënligjore të KQZ-së;
g) nuk zbaton vendimet e KQZ-së.
Propozimi për shkarkimin e anëtarit të KZQV-së mundet të bëhet nga çdo subjekt zgjedhor, nga KZQV-ja ose nga një anëtar i KQZ-së.
KQZ-ja merr vendim për shkarkim, kur votojnë shumica e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

Neni 6

1. Në qoftë se një parti politike me anëtar në KZQV, nuk cakton kandidat për kryetar bashkie ose komune ose nuk ka paraqitur listë shumëëmërore për këshillin vendor, ajo humbet vendin në KZQV.
2. Në këtë rast, të drejtën e propozimit e ka partia e rradhës sipas zgjedhjeve përkatëse të të njëjtit spektër politik.

Plotësimi i vendit vakant

Neni 7

Kur vendi i një anëtarit të KZQV-së për çfarëdolloj shkak u ngelet vakant, KQZ-ja i kërkon partisë politike përkatëse të sjellë propozimin për anëtarin e ri.
Kur anëtar i KZQV-së, jep dorëheqjen, ajo depozitohet pranë KZQV-së, e cila e dërgon menjëherë në KQZ.

Neni 8

Kur vendi i anëtarit të KZQV-së ngelet vakant ditën e votimit deri në shpalljen e rezultatit, njoftohet menjëherë KQZ-ja, e cila pasi bën verifikimet përkatëse merr vendim për deklarimin e vakancës. Më pas fillojnë procedurat për emërimin e anëtarit të ri. Në këtë rast, KQZ-ja cakton një afat dhe i kërkon partisë përkatëse të bëjë menjëherë zëvendësimin.
Në rast se partia politike refuzon të dërgojë propozimin, KQZ-ja ka të drejtë të caktojë një anëtar në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 6 të këtij udhëzimi.

PJESA III

EMËRIMI DHE SHKARKIMI I KRYETARIT DHE ZV/KRYETARIT TË KZQV-SË

Neni 9

Zgjedhja e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të KZQV-së

Kryetari dhe zëvendëskryetari zgjidhen sipas procedurës së parashikuar në nenin 40/1.c të Kodit Zgjedhor.
Propozimi i paraqitet KQZ-së me vendim të KZQV-së përkatëse.
Mbledhjen e KZQV-së për propozimin e kryetarit dhe të zëvendëskryetarit, kur asnjë prej tyre nuk është zgjedhur nga KQZ-ja, e drejton anëtar i më i vjetër në moshë.
Anëtar i më i ri mban procesverbalin e mbledhjes.
KZQV-ja merr vendim për t'i propozuar KQZ-së, sipas rastit kryetarin ose zëvendëskryetarin, anëtarin që ka marrë më shumë vota në përfundim të votimit.

Neni 10

Shkarkimi kryetarit dhe zëvendëskryetarit

Kryetari ose zëvendëskryetari i KZQV-së shkarkohet për shkaqet e mëposhtme:
a) nuk përmbush kriteret dhe kushtet e parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe në këtë udhëzim për të qenë kryetar ose zëvendëskryetar;
b) nuk zbaton detyrimet që rrjedhin nga Kodi Zgjedhor, vendimet dhe udhëzimet e KQZ-së.
Shkarkimi i kryetarit ose sipas rastit i zëvendëskryetarit bëhet me vendim të KQZ-së me

propozim të jo më pak se tre anëtarëve të KZQV-së ose të dy anëtarëve të KQZ-së.

Anëtari i KZQV-së i shkarkuar nga detyra e kryetarit ose zëvendëskryetarit nuk mundet të rizgjidhet në këtë detyrë.

Në propozimin e ri KZQV-ja respekton kërkesat e nenit 40/1.c të Kodit Zgjedhor.

PJESA IV

EMËRIMI DHE SHKARKIMI I SEKRETARIT TË KZQV-SË

Neni 11

Emërimi i sekretarit të KZQV-së

Sekretari i KZQV-së emërohet nga KQZ-ja me propozim të KZQV-së.

Sekretari duhet të jetë jurist dhe ka statusin e anëtarit pa të drejtë vote në KZQV.

KZQV-ja merr vendim për personin që do t'i propozohet KQZ-së për sekretar.

Propozimin në KZQV për kandidaturën që do t'i paraqitet KQZ-së për sekretar ka të drejtë ta paraqesë vetëm zëvendëskryetari i KZQV-së.

KZQV-ja merr vendim në këtë rast, kur votojnë shumica e anëtarëve me të drejtë vote.

Votimi bëhet i fshehtë.

Neni 12

Shkarkimi i sekretarit të KZQV-së

Sekretari i KZQV-së mundet të shkarkohet për një nga kushtet e mëposhtme:

a) nuk përmbush kriteret dhe kushtet e parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe në këtë udhëzim për të qenë sekretar;

b) nuk zbaton detyrimet që rrjedhin nga Kodi Zgjedhor, vendimet dhe udhëzimet e KQZ-së dhe vendimet e KZQV-së.

Shkarkimi i sekretarit bëhet me vendim të KQZ-së, me propozim të jo më pak se tre anëtarëve të KZQV-së ose të dy anëtarëve të KQZ-së.

PJESA V

TË DREJTAT DHE DETYRAT E ANËTARËVE TË KZQV-SË

Neni 13

Të drejtat e anëtarit të KZQV-së

Anëtari i KZQV-së ka të drejtën e shpërblimit për punën e bërë si anëtar i KZQV-së.

Masa e shpërblimit për periudhën zgjedhore dhe atë jozgjedhore parashikohet me vendim të KQZ-së.

Gjatë kohës që anëtari i KZQV-së ushtron këtë detyrë përfiton pagë të plotë nga punëdhënësi.

Në periudhën e rishikimit të listës paraprake dhe atë zgjedhore anëtari i KZQV-së ushtron vetëm detyrën e anëtarit të KZQV-së dhe i ruhet vendi i mëparshëm i punës.

Në rastet kur anëtari i KZQV-së ndalohet ose arrestohet, gjatë periudhës zgjedhore, organi kompetent njofton menjëherë KQZ-në.

Neni 14

Detyrat e anëtarit të KZQV-së

Anëtari i KZQV-së është i detyruar të zbatojë Kushtetutën, Kodin Zgjedhor, vendimet dhe udhëzimet e KQZ-së.

Anëtari i KZQV-së është i detyruar të paraqitet në vendin e punës në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë udhëzim.

Anëtarët e KZQV-së duhet të paraqiten rregullisht në detyrë, me përjashtim të rasteve të justifikuara.

Në rast shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor, anëtarët e KZQV-së mbajnë përgjegjësi

administrative ose penale, në varësi të shkeljes së kryer.

PJESA VI TË DREJTAT DHE DETYRAT E KRYETARIT DHE ZV/KRYETARIT TË KZQV-SË

Neni 15

Të drejtat dhe detyrat e kryetarit dhe zv/kryetarit të KZQV-së

Kryetari i KZQV-së ka këto kompetenca:

- Drejton mbledhjet e KZQV-së.
- Përfaqëson KZQV-në në marrëdhëniet me të tretët.
- Në bashkëpunim me sekretarin administron të gjithë dokumentacionin dhe buxhetin e KZQV-së, sipas vendimit të marrë nga KZQV-ja.
- Zbaton detyra të tjera të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe aktet normative të KQZ-së.
- Kryetari dhe zv/kryetari i KZQV-së janë të detyruar të nënshkruajnë të gjitha vendimet e KZQV-së, krahas nënshkrimit të tyre deklarojnë votën “pro” ose “kundër”.
- Zv/kryetari KZQV-së kryen detyrat e kryetarit në mungesë të tij.

PJESA VII TË DREJTAT DHE DETYRAT E SEKRETARIT TË KZQV-SË

Neni 16

Sekretari i KZQV-së ka këto të drejta:

- Merr pjesë në mbledhjet e KZQV-së si anëtar pa të drejtë vote.
- Nën drejtimin e kryetarit ose zv/kryetarit administron të gjithë dokumentacionin e KZQV-së.
- Jep asistencë juridike për KZQV-në.
- Kujdeset për përgatitjen dhe zhvillimin e rregullt të mbledhjeve të KZQV-së.
- Mban rregullisht procesverbalet e mbledhjeve të KZQV-së, si dhe zbardh vendimet që merren prej saj.
- Mban listëprezencën e anëtarëve të KZQV-së.
- Në bashkëpunim me kryetarin administron buxhetin e KZQV-së dhe në përfundim përpilon një tabelë me të gjithë zërat e shpenzimeve.
- Kryen detyra të tjera të parashikuara nga ligji dhe akte të tjera të nxjerra nga KQZ-ja dhe nga KZQV-ja.

PJESA VIII ANËTARËT PA TË DREJTË VOTE

Neni 17

Partitë politike që janë regjistruar në KQZ dhe që nuk kanë anëtarë në KZQV, kanë të drejtë të caktojnë përfaqësues pa të drejtë vote në këtë komision.

Caktimi i tyre bëhet vetëm pasi partitë paraqesin kandidatët për kryetar bashkie/komune ose listat shumëemërore për këshillat vendorë. Përfaqësuesit pa të drejtë vote, regjistrohen nga sekretari në procesverbalin e KZQV-së dhe pajisen nga ai me dokumentin përkatës identifikues, sipas modelit të caktuar nga KQZ-ja.

Ata kanë të drejtë të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e KZQV-së, të diskutojnë dhe të paraqesin propozime e kërkesa, të marrin kopje të akteve të KZQV-së, të kërkojnë informacion për të gjitha aspektet e veprimtarisë së KZQV-së dhe t'i vëzhgojnë ato.

Kandidatët e pavarur kanë të drejtë të paraqesin një përfaqësues pa të drejtë vote në KZQV. Emri i përfaqësuesit shënohet në dokumentet e kandidimit të kandidatit të pavarur.

PJESA IX
DETYRAT DHE FUNKSIONIMI I KZQV-SË

Neni 18
Detyrat e KZQV-së

Komisioni Zgjedhor për Qeverisjen Vendore, kryen këto detyra:

- përgjigjet për administrimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore;
- përgjigjet për shpalljen, rishikimin dhe miratimin e listave paraprake të zgjedhësve të bashkisë ose të komunës përkatëse, sipas rregullave të parashikuara në “Kodin Zgjedhor” dhe udhëzimeve të KQZ-së;
- merr pjesë në programet e trajnimit të organizuar nga KQZ-ja;
- verifikon në mënyrë të vazhdueshme përbërjen e KZQV-së;
- bashkëpunon me KQZ-në dhe organet e qeverisjes vendore për sigurimin e bazës së nevojshme logjistike për funksionimin e KZQV-së;
- verifikon qendrat e votimit dhe gjendjen e objekteve, ku janë vendosur këto qendra gjatë zgjedhjeve të fundit;
- vlerëson mundësitë për caktimin e vendndodhjes së qendrave të votimit në objekte publike, si dhe iu cakton atyre një numër sipas “Sistemit unik të numërimit”.
- vlerëson mundësitë për caktimin e vendndodhjes së qendrave të votimit në ambiente, të cilat lehtësojnë pjesëmarrjen në votim edhe të personave me aftësi të kufizuara;
- vendos kontakte me organet e qeverisjes vendore, si dhe me punonjësin ndërlidhës;
- pranon dhe verifikon dokumentacionin për paraqitjen e kandidatëve për kryetar komune apo bashkie ose për këshillin e bashkisë ose të komunës;
- përpara se të ketë filluar procesi i votimit, KZQV-ja verifikon masat që janë marrë për sigurimin e qendrave të votimit, si dhe hapjen në kohë të procesit të votimit në të gjithë njësinë zgjedhore që ata kanë në administrim;
- emëron kryetarin, zv/kryetarin, sekretarin dhe anëtarët e KQV-ve;
- administron buxhetin e caktuar nga KQZ-ja;
- merr në dorëzim nga KQV-të materialet e votimit dhe kutitë e votimit;
- kontakton me strukturat lokale të subjekteve politike në lidhje me ndryshimet e mundshme të anëtarësisë së KQV-së, në përputhje me përcaktimet e Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë;
- kontakton me KQZ-në dhe jep informacion të vazhdueshëm javor mbi aktivitetin e KZQV-së, anëtarësinë e KZQV-së dhe problemet që dalin gjatë punës së KZQV-së;
- bashkëpunon me KQZ-në për përgatitjen e hartave zgjedhore për njësinë vendore përkatëse;
- mbledh të dhënat për anëtarët e KZQV-së, sipas mënyrës së përcaktuar nga KQZ-ja;
- njihet me aktet e KQZ-së;
- përgatit tabelën e rezultateve të zgjedhjeve për njësinë vendore dhe ia dërgon atë KQZ-së, së bashku me materialet e tjera të nevojshme në përputhje me nenin 110 të Kodit Zgjedhor;
- shpall rezultatin e zgjedhjeve në njësinë vendore përkatëse;
- KZQV-ja organizon dhe bën procesin e rinumërimit të fletëve të votimit;
- ndan mandatet e këshillave vendorë;
- administron zgjedhjet e pjesshme në njësinë vendore përkatëse;
- regjistron çdo kërkesë dhe ankesë të subjekteve zgjedhore në një dosje të veçantë;
- merr vendim për të gjitha kërkesat dhe ankesat e subjekteve zgjedhore.

Neni 19
Zyra e KZQV-së

Çdo zyrë KZQV-je duhet të ketë në hyrje të saj tabelën, e cila përmban emrin e zyrës, numrin e telefonit dhe orarin e funksionimit. Çdo KZQV duhet të ketë flamurin kombëtar.

Neni 20
Dokumenti i identifikimit

Gjatë ushtrimit të detyrës anëtarët dhe sekretari i KZQV-së, janë të detyruar të mbajnë në mënyrë të dukshme dokumentet e identifikimit sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja.

Përfaqësuesit e kandidatëve dhe të partive politike (pa të drejtë vote) janë të detyruar, që gjatë qëndrimit në ambientet e KZQV-së, të mbajnë dokumentet e identifikimit, sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja. Këto të fundit janë të firmosura nga kryetari, nënkryetari dhe të vulosura me vulën e KZQV-së nga sekretari.

Neni 21
Vula e KZQV-së dhe përdorimi

KZQV-ja vulos të gjitha aktet e saj me vulën e miratuar nga KQZ-ja.

Vula e KZQV-së mbahet nga sekretari, i cili e administron dhe e përdor në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe aktet nënligjore të KQZ-së.

Në rast se vula e KZQV-së humbet ose dëmtohet, apo për ndonjë arsye tjetër nuk mund të përdoret gjatë veprimtarisë së KZQV-së, atëherë KZQV-ja harton një procesverbal, ku sqarohen qartësisht arsyet e mungesës ose pamundësisë së përdorimit të vulës dhe ia bën këtë me dije KQZ-së. KQZ-ja vlerëson informacionin e paraqitur dhe realizon procedurat e nevojshme për pajisjen e KZQV-së me vulën e re.

PJESA X
MBLEDHJET E KZQV-SË

Neni 22
Njoftimi për mbledhjet e KZQV-së

Mbledhja e parë e KZQV-së pas ringritjes thirret me vendim të KQZ-së.

Njoftimi për mbledhjen e KZQV-së botohet në 4 gazetat më të mëdha me qarkullim kombëtar dhe në radiot dhe televizionet kombëtare.

Njoftimi iu dërgohet partive politike, të cilat kanë propozuar anëtarët e KZQV-së dhe përmban datën dhe orën e mbledhjes së parë, si dhe vendin ku do të zhvillohet mbledhja.

Njoftimi për thirrjen e mbledhjes i dërgohet nëpunësit ndërlidhës të bashkisë/komunës, i cili është përgjegjës për njoftimin e anëtarëve të KZQV-së, si dhe për krijimin e kushteve për zhvillimin e mbledhjes në ambientet e bashkisë/komunës.

Procedura e zhvillimit të mbledhjeve të KZQV-së

Neni 23

KZQV-ja jashtë periudhës zgjedhore dhe asaj për rishikimin e listës paraprake duhet të mbledhet jo më pak se 1 herë në dy muaj.

Në periudhën e rishikimit të listës paraprake dhe asaj zgjedhore, KZQV-ja qëndron e mbledhur në mënyrë permanente, sipas orarit të përcaktuar në këtë udhëzim.

Mbledhjet e KZQV-së thirren nga kryetari dhe zëvendëskryetari ose së paku nga dy anëtarë.

Sekretari është përgjegjës për njoftimin e anëtarëve për mbledhjen e KZQV-së.

Mbledhjet e KZQV-së zhvillohen, vetëm në ambientin e punës së KZQV-së.

Mbledhjet e KZQV-së zhvillohen kur marrin pjesë të paktën 4 anëtarë.

Në fillim të çdo mbledhje, sekretari duhet të shënojë pjesëmarrësit dhe çështjet që do të trajtohen.

Në ditën e zgjedhjeve sekretari i KZQV-së mban një procesverbal të veçantë, sipas modelit të përgatitur nga KQZ-ja, në të cilin shënohen për çdo dy orë kërkesat dhe pretendimet që paraqiten nga subjektet zgjedhore.

Në përfundim të çdo dy orëshi ky procesverbal firmoset nga të gjithë anëtarët.

Në përfundim të mbledhjes, procesverbali firmoset nga të gjithë anëtarët e KZQV-së që kanë

marrë pjesë në mbledhje.

Neni 24

Drejtuesi i mbledhjes paraqet çështjet që janë për shqyrtim sipas radhës së vendosur në rendin e ditës dhe i jep fjalën anëtarëve për të diskutuar.

Çdo anëtar i KZQV-së ka të drejtë të diskutojë lidhur me çështjen e shtruar për shqyrtim, të prezantojë fakte dhe prova, të jap argumente të bazuara në ligj, si dhe të paraqesë propozime konkrete për zgjidhjen e problemeve, që dalin.

Në mbledhje u jepet fjala për të bërë pyetje ose diskutime edhe përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore.

Neni 25

Koha e punës e KZQV-së

Gjatë periudhës së rishikimit të listave paraprahe të zgjedhësve dhe deri dy ditë para datës së zgjedhjeve, KZQV-ja punon paradite nga ora 8.00–13.00 dhe mbasdite 16.00–20.00.

Dy ditë para zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit dhe dorëzimin në KQZ të dokumentacionit zgjedhor, KZQV-ja është e detyruar të qëndrojë në mënyrë permanente e mbledhur në zyrë.

KZQV-ja ngarkon sekretarin që të bëjë publike vendndodhjen e zyrës së KZQV-së, numrin e telefonit, orarin e punës etj.

PJESA XI

VENDIMMARRJA

Neni 26

Mbyllja e diskutimeve dhe votimi i propozimeve

Pas diskutimeve, drejtuesi i mbledhjes mbyll diskutimet dhe kalon në votimin e propozimeve të paraqitura.

Anëtarët e KZQV-së marrin vendimet e tyre në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore të KQZ-së, duke u bazuar në bindjen e tyre të brendshme. Për mbarëvajtje sa më të mirë të procesit zgjedhor, KZQV-ja është e detyruar që gjatë procesit të vendimmarrjes dhe të nxjerrjes së rezultateve të ndërpresë çdo komunikim me jashtë këtyre ambienteve (telefon celular, telefon i zakonshëm, hyrje–dalje personash të paautorizuar etj.) .

Neni 27

Procedura e votimit dhe firmosja e vendimeve

Vendimet e KZQV-së në lidhje me regjistrimin e kandidatëve, rishikimin dhe miratimin e listave paraprahe, shpalljen e rezultateve dhe fituesve merren, kur votojnë pro pesë anëtarë të komisionit.

Vendimet e tjera merren me shumicën e votave në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve me të drejtë vote.

Vendimet e KZQV-së nënshkruhen domosdoshmërisht nga kryetari dhe zëvendëskryetari. Vendimet shoqërohen me mendimin e pakicës. Secili prej anëtarëve të KZQV-së, krahas nënshkrimit të tij në vendim, deklaron votën “pro” ose “kundër” dhe sekretari i KZQV-së shënon në procesverbal procedurat e votimit. Anëtar i KZQV-së nuk mund të abstenojë.

Të gjitha vendimet e marra gjatë rinumërimit të fletëve të votimit, konsiderohen vendime të ndërmjetme dhe janë vendime të formës së prerë. Rezultatet e shpallura janë vendime të ankimueshme.

PJESA XII
DOKUMENTACIONI I KZQV-SË

Neni 28

a) Komisioni Zgjedhor i Qeverisjes Vendore merr vendime lidhur me çështje që hyjnë në kompetencën dhe juridiksionin e tij.

KZQV-ja mban procesverbale lidhur me veprimtarinë e kryer, si dhe përpilon raporte mbi veprimtarinë e vet për KQZ-në.

KZQV-ja është e detyruar që të bëjë menjëherë publike vendimet e marra dhe të dërgojë në KQZ një kopje të këtyre vendimeve.

Aktet e mësipërme hartohen, sipas modeleve të përcaktuara nga KQZ-ja.

b) Sekretari i KZQV-së është përgjegjës për ruajtjen dhe sistemimin e dokumentacionit të KZQV-së. Sekretari mban procesverbalin e KZQV-së ku pasqyron saktë dhe në mënyrë të detajuar të gjithë veprimtarinë e KZQV-së, përfshirë këtu edhe mbledhjet e KZQV-së. Procesverbali firmoset detyrimisht nga anëtarët e KZQV-së.

c) Pasqyrimi i mbledhjeve të KZQV-së në procesverbal duhet të përmbajë të paktën:

1. datën, vendin dhe orën e mbledhjes;
 2. anëtarët që morën pjesë;
 3. çështjet që u diskutuan;
 4. një përmbledhje të gjithçkaje që u tha në mbledhje;
 5. vendimet që u morën;
 6. forma dhe rezultati i votimit të anëtarëve të KZQV-së.
- Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr.149, datë 20.7.2003

PËR HEQJEN E LICENCËS SË ALBA TV

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Sefedin Çela Kryetar
Albert Minga Zëvendëskryetar
Apostol NotiAnëtar
Pashk PërvathiAnëtar
Lazër StaniAnëtar
Ilir KullaAnëtar

Mori në shqyrtim çështjen që i përket:

Ankues: Subjekti televiziv ALBA TV, përfaqësuar nga Americo Di Domenicantonio, aksioner i shoqërisë "ALBA TV" sh.a dhe avokati z.Arben Hakani.

Objekt: Për heqjen e licencës së subjektit ALBA TV.

Baza ligjore: Neni 7 pika 21, neni 22, neni 34 pikat 2 dhe 5, si dhe neni 33 pika 5 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë".

Me vendimin nr.147, datë 27.6.2003 "Mbi vlefshmërinë e licencës së ALBA TV", këtij subjekti i është lënë një afat prej 15 ditësh, për të dhënë mendimin e tij në lidhje me këtë vendim. Brenda afatit të mësipërm, ankuesi ALBA TV ka parashtruar përpara Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit këto argumente:

- Nuk është plotësuar afati 30 ditor i mostransmetimit në një vit kalendarik.
- Problemi i një marrëveshjeje bashkëpunimi është i zgjidhur, pasi është modifikuar logo e transmetimit dhe përmbajtja e marrëveshjes. Bashkëpunimi me televizionin "ALSAT" konsiston

aktualisht në programet e përbashkëta dhe individuale, që kanë gjithmonë për logo "ALBA", kjo lehtësisht e verifikuar, pasi ndër të tjera edhe "ALSAT" transmeton programet e "ALBA TV" në frekuencën e tij. Lidhja e kësaj marrëveshjeje ka ardhur edhe si rezultat i mosrespektimit të marrëveshjeve me subjekte të tjera kontraktuese, siç është p.sh. rasti me Bashkinë e Tiranës. Shkak tjetër është edhe varfëria financiare me të cilën po përballët "ALBA TV" dhe qëllimi për të mbijetuar.

- Në lidhje me detyrimet financiare për vitet 2001-2003 kërkohet pagimi i detyrimit faktik brenda një periudhe 3 muajore, duke filluar pagesat në 15-ditëshin e dytë të korrikut.

- Transmetimet e reklamës së shërbimit telefonik me vlerë të shtuar kanë qenë një burim të ardhurash.

- Përsa i përket filmave pa titrim, janë fare pak të konsiderueshëm në arkiv.

KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE TELEVISIONIT,

pasi dëgjoi relatorët e çështjes, Argita Shkupi, Andrea Nathanaili, Mira Mushi, si dhe pretendimet e subjektit, përfaqësuar nga Americo Di Domenicantonio, aksioner i shoqërisë "ALBA TV" sh.a. dhe avokati Z. Arben Hakani,

V Ë R E N:

I. Në muajin maj 2003 subjekti "ALBA TV" ka ndërprerë transmetimet e programeve të tij.

KKRT me iniciativën e vet, mbështetur në ligj, ka ndërmarrë një sërë veprimesh për t'i dalë përpara në momentin e duhur shkeljeve të ligjit nga ana e këtij subjekti.

KKRT, pasi "ALBA TV" ndërpreu transmetimet e programeve të veta, duke mos njoftuar dhe duke mos dhënë asnjë arsye teknike, organizative ose programore në KKRT, me shkresën nr. 313, datë 27.5.2003 kërkon nga "ALBA TV" të dijë arsyet e ndërprerjes së transmetimeve, duke i kujtuar se në bazë të nenit 34 pika 5 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", KKRTka të drejtë të heqë licencën e transmetimit, kur pas fillimit të transmetimit, gjatë një viti kalendarik, nuk transmetohet 30 ditë, pa llogaritur ndërprerjet për arsye teknike, që nuk varen nga mbajtësi i licencës.

Nëpërmjet shkresës kërkohej informacion për ndërprerjen e transmetimit dhe shpresohej në përmirësimin e situatës. Deri në këtë moment "ALBA TV" dilte në transmetim vetëm me test teknik.

Në përgjigjen e datës 28.6.2003 "ALBA TV" sqaron se janë problemet administrative të saj me Qendrën Ndërkombëtare të Kulturës, që bëjnë të pamundur transmetimin dhe se është duke u organizuar për një dalje sa më të shpejtë në transmetim.

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi bëri verifikime në kanalën 25, identifikoi me figurë transmetuesin satelitor "ALSAT", ndërsa në pistën zanore filloi transmetimi i programeve të Radios "ALSAT". KKRT e vlerësoi të paligjshëm huazimin e frekuencave të "ALBA TV", për transmetues të tjerë radiotelevizivë. Në shkresën e datës 4.6.2003 me nr.328 prot, është kërkuar ndërprerja menjëherë e këtij huazimi të paligjshëm dhe theksohej se "ALBA TV" është licencuar për të transmetuar programe me karakter informativ, kulturor dhe edukativ dhe se frekuencat e tij nuk mund të përdoren në asnjë rast nga transmetues të tjerë radiotelevizivë thjesht si përsëritës që të identifikojnë programin e tyre. Për këtë shkelje "ALBA TV" është paralajmëruar dhe me shkresën nr.343, datë 9.6.2003.

Në datën 5.6.2003 në KKRT është paraqitur nga televizioni "ALSAT" një marrëveshje bashkëpunimi e lidhur në datën 4.6.2003 ndërmjet "ALBA TV" dhe "ALSAT TV", me objekt vënien në dispozicion të ALSAT TV, të rrjetit të transmetimit të "ALBA TV", si dhe gjithçka tjetër për ritransmetimin e programeve të saj.

Në datën 24.6.2003 është paraqitur nga ana e "ALBA TV" një marrëveshje e bashkëpunimi e lidhur në datën 23.6.2003, e cila anulon marrëveshjen e datës 4.6.2003. Objekti i kësaj marrëveshjeje është vënia në dispozicion e aparaturave dhe stafit krijues nga ana e "ALBA TV" për realizimin e programeve të përgatitura në bashkëpunim me "ALSAT TV". Kurse "ALSAT TV" vë në dispozicion ambientet, studiot, aparaturat, stafin e tij krijues dhe çdo gjë tjetër që do t'i shërbejë objektit dhe qëllimit të këtij bashkëpunimi.

Duke pasur parasysh se në mbështetje të nenit 22 të ligjit, licenca e transmetimit është e patjetërsueshme dhe vlen vetëm për subjektin të cilit i është dhënë, KKRT-ja, e vlerëson këtë

marrëveshje të paligjshme dhe rrjedhimisht të pazbatueshme.

Në këtë kohë, në kanal 25 të lejuar për "ALBA TV", transmetoheshin programet e televizionit satelitor "ALSAT". Në ekran shfaqeshin të dyja logot e subjekteve të licencuara, "ALSAT" dhe "ALBA".

Në datën 13.6.2003, pas kërkesës së bërë nga ana e KKRT-së u zhvillua një takim me 2 përfaqësues të "ALBA TV" dhe përfaqësues të KKRT-së. Në këtë takim iu parashtruan pretendimet e KKRT-së subjektit "ALBA TV", i cili nga ana e tij kërkoj një ditë tjetër për të paraqitur objeksionet e veta. Në datën 16.6.2003 "ALBA TV" dërgon një shkresë, ku shprehet se nuk ka një tjetërsim të licencës dhe as kalim të drejtash në marrëdhënien e bashkëpunimit me "ALSAT"... duke kërkuar edhe mirëkuptimin nga ana e KKRT-së për këtë çështje.

Në datën 14.6.2003 u hoq fare nga ekrani logoja e televizionit "ALSAT" dhe programi i "ALSAT" transmetohej në kanal 25 të lejuar për "ALBA TV".

Në këto kushte, subjekti ALBA TV nuk respekton strukturën programore, lidhja nr.II e licencës nr.040/TVL të miratuar nga KKRT, pra nuk plotëson kushtet për të cilat është dhënë licenca, gjë që sipas nenit 34 pika 2 ndëshkohet me heqjen e licencës.

II. Gjithashtu, në vijim të korrespondencës mes departamentit ekonomik të KKRT-së dhe "ALBA TV" në vitet 2001-2003 dhe problemet e trajtuara në takimet verbale ndërmjet palëve, rezultojnë:

- Televizioni "ALBA TV" është licencuar me 3.1.2001 për të mbuluar me sinjal televiziv zonën e licencimit të përbërë nga katër prefekturat: Tiranë, Durrës, Lezhë dhe Fier. Detyrimet financiare vjetore për këtë zonë licencimi, në formën e pagesës vjetore për licencë, për çdo vit licencimi, duke filluar nga viti 2001 e në vazhdim për pesë vjet, janë 500.300 lekë në vit. Llogaritjet bazohen në numrin e popullsisë së kësaj zone licencimi.

- Për vitin 2001 nga subjekti "ALBA TV" është bërë pagesë pjesore e detyrimit, në masën prej 114.300 lekë nga 500.300 lekë. Për vitin 2002 është shlyer detyrimi vjetor në shumën prej 500.300 lekë për pagesën e licencës, ndërsa nuk është shlyer për vitin 2003 po për këtë shumë.

Në mënyrë të përmbledhur, detyrimi ndaj KKRT, në formën e pagesës vjetore për licencë, për tre vitet (2001 - 2003) është në masën 886.300 lekë (386.000 + 500.300).

Taksat për shërbimet RTV janë detyrim ndaj DP të tatim-taksave, të llogaritura në bazë të numrit dhe fuqisë së rrezatimit të transmetuesve dhe përsëritësve të poseduar nga subjekti "ALBA TV".

- Për vitin 2001 shuma e taksave për shërbimet RTV ishte 360.000 lekë. Janë paguar vetëm 40.000 lekë, duke mbetur si detyrim shuma prej 320.000 lekë. Për vitin 2002 dhe 2003 detyrimi i taksave është i njëjtë, në masën prej 300.000 lekë. Ky detyrim nuk është paguar për këto dy vite.

- Në mënyrë të përmbledhur, detyrimi ndaj shtetit, në formën e taksave për shërbimet RTV për tre vitet (2001-2003) është në masën prej 920.000 lekë (320.000 + 300.000 + 300.000).

- Në dosjen e paraqitur nga subjekti "ALBA TV", plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm për përmblidhjen e kërkesave për licencim, nuk është depozituar dokumenti i regjistrimit në organet tatimore, Kodi Fiskal ose NIPT-i, dokumente, të cilat merren pasi miratohet dhënia e licencës për ushtrimin e aktivitetit, konkretisht në fushën e mediave radiotelevizive.

- Nuk është paraqitur në KKRT, një kopje e bilancit kontabël, për pasqyrimin e aktivitetit të ushtruar gjatë vitit 2001 dhe 2002, sipas kërkesës së nenit 48 të ligjit, me gjithë kërkesat e herëpashershme nga ana e departamentit ekonomik të KKRT-së.

Për mosrealizim të detyrimeve financiare të parashikuara me ligj, neni 33 pika 5 e ligjit nr. 8410 parashikon pavlefshmërinë e licencës.

Gjithashtu, herë pas here ndaj "ALBA TV" janë vendosur sanksione të ndryshme, nëpërmjet të cilave kërkohej funksionimi i saj konform kërkesave të ligjit. Përmendim:

- Në datën 18.12.2002 me shkresën nr.873 prot., "ALBA TV" paralajmërohet për shkeljen në mënyrë të përsëritur të vendimit nr.122, datë 31.10.2002 të KKRT-së, që disiplinon transmetimin e reklamave të shërbimit telefonik me vlerë të shtuar.

- Po për këtë shkelje, "ALBA TV" është paralajmëruar njëherë me datën 11.11.2002 me shkresën nr. 876 prot.

- Në datën 5.6.2002 me shkresën nr.457 prot., "ALBA TV" paralajmërohet pasi filmat e transmetuara prej saj janë të patitruar ose të padubluar në gjuhën shqipe, duke shkelur kërkesat e nenit 37 të ligjit nr.8410 datë 30.9.1998.

- Me vendimin nr.131, datë 29.1.2003 pika 2 të KKRT-së (bazuar në nenin 33 të ligjit) është vendosur për subjektin ALBA TV reduktimi i kohës së vlefshmërisë së licencës nga 5 vjet në 4 vjet.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, të nenit 22, 34 pikat 2 dhe 5, si dhe të nenit 33 pika 5 të ligjit nr.8410 datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë",

V E N D O S I:

1. T'i heqë licencën subjektit ALBA TV.
 2. Subjekti ALBA TV është i detyruar të ndërpresë transmetimin.
 3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Kur është e domosdoshme, mbështetur në nenin 137/5 "Bashkëpunimi me organet e tjera" të bashkërendohen veprimet me organet tatimore e policore.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

V E N D I M
Nr.150, datë 30.7.2003

PËR DHËNIE LICENCE
PËR RITRANSMETIM TË PROGRAMEVE TË HUAJA TELEVIZIVE NË SHQIPËRI

"RAI 1"
SUBJEKTIT: RADIOTELEVISIONI ITALIAN

(Përfaqësuar nga RTSH)

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

V E N D O S I:

1. T i japë subjektit Radiotelevizioni Italian RAI 1 licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator për ritransmetimin e programeve të veta televizive me përsëritës, për një periudhë prej 4 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

V E N D I M
Nr.153, datë 30.7.2003

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT

"TV APOLLON"
SUBJEKTIT: SHOQËRIA "F.K.T." SH.P.K.

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në datat 10 dhe 18 qershor të vitit 2003, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

V E N D O S I:

1. T'i japë subjektit, shoqërisë "F.K.T." sh.p.k. me vendndodhje në qytetin e Fierit, licencë duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

V E N D I M
Nr.154, datë 30.7.2003

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT

"2A TV"
SUBJEKTIT: Z. ARJAN SOTIRI

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në datat 10 dhe 18 qershor të vitit 2003, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

V E N D O S I:

1. T'i japë subjektit, Z. Arjan Sotiri me vendndodhje në qytetin e Kavajës, licencë duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

V E N D I M
Nr.155, datë 30.7.2003

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT "TV MALËSIA"

SUBJEKTIT: Z. ISUF HEBA

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në datat 10 dhe 18 qershor të vitit 2003, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

V E N D O S I:

1. T'i japë subjektit, Z. Isuf Heba me vendndodhje në Malësinë e Madhe, licencë duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

V E N D I M
Nr.156, datë 30.7.2003

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT

"TV JEHONA E MALËSISË"
SUBJEKTIT: Z. NAZMI JUBANI

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në datat 10 dhe 18 qershor të vitit 2003, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

V E N D O S I:

1. T'i japë subjektit, Z. Nazmi Jubani me vendndodhje në Malësinë e Madhe, licencë duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

V E N D I M
Nr.157, datë 30.7.2003

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT "TV BUSHATI"

SUBJEKTIT: Z. SIMON GJONDREKAJ

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në datat 10 dhe 18 qershor të vitit 2003, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

V E N D O S I:

1. T'i japë subjektit, Z. Simon Gjondrekaj me vendndodhje në Bushat, licencë duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

V E N D I M
Nr.158, datë 30.7.2003

PËR DHËNIE LICENCE
PËR RADIO VENDORE PRIVATE

"MAGIC"

SUBJEKTIT: Z. KUJTIM HASANI

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

V E N D O S I:

1. T'i japë subjektit, Z. Kujtim Hasani, me vendndodhje në Kavajë, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor radio FM private, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

Doli nga shtypi më 3.9.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë